



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Ligji Nr. 02/L-118

PËR EMRIN PERSONAL

Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të Kreut 5.1 dhe 9.1.26 (a) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),
Me qëllim të vendosjes së rregullave ligjore për Emrin Personal.

Miraton:

LIGJIN PËR EMRIN PERSONAL

Kreu I

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj e rregullon kuptimin, përbërjen, procedurën dhe mënyrën e caktimit dhe të përdorimit të emrit personal, si dhe kushtet për, ndryshimin dhe korrigjimin e tij për qytetarët e Kosovës (në vazhdim të tekstit: qytetarët).

Neni 2

Përkufizimet

Emri Personal- nënkupton emrin dhe mbiemrin e qytetarit të Kosovës.

Qytetarët- nënkuptojmë banorët e përhershëm të Kosovës.

Komunikimi juridik – nënkupton, tërësinë e normave juridike të cilat rregullojnë korrespondencën ndërmjet organit të administratës dhe organeve shtetërore me qytetarë duke përfshirë çdo veprim tjetër që ka pasojë juridike.

Regjistri i gjendjes civile – nënkupton librat ku mbahen shënimet për gjendjen personale të qytetarëve lidhur me faktet e të gjitha lindjeve, martesave, vdekjeve dhe të dhënave të tjera që burojnë prej tyre.

Neni 3 Emri personal

- 3.1. Emri personal i garanton qytetarit identitetin, ruajtjen e personalitetit dhe dinjitetit të tij.
- 3.2. Emri personal është e drejtë e qytetarit dhe përdoret për identifikimin dhe dallimin e tij.
- 3.3. Qytetari është i obliguar ta përdor emrin personal në komunikimin juridik.
- 3.4. E drejta për caktimin e emrit personal mund të kufizohet, nëse kjo është e domosdoshme për ruajtjen e moralit, të drejtave dhe të lirive të njerëzve të tjerë apo të vetë personit.

Neni 4 Përbërja e emrit personal

- 4.1. Emri personal përbehet nga emri dhe mbiemri.
- 4.2. Emri ose mbiemri, secili në vete mund të përbëhen nga më shumë fjalë, të cilat e ndërtojnë tërësinë e emrit personal.
- 4.3. Personi nga paragrafi 2 i këtij neni është i obliguar që ta përdorë emrin personal të plotë në komunikimin juridik.

Neni 5 Fitimi i emrit personal

Emri personal fitohet me regjistrim në regjistrin përkatës të gjendjes civile sipas vendit të lindjes.

Neni 6 Përdorimi i gjuhës për emrin personal

- 6.1. Emri personal i qytetarit shkruhet në regjistrin përkatës të gjendjes civile në gjuhën e tij, përveç rasteve kur ai përcaktohet për ndonjë gjuhë tjetër zyrtare të Kosovës.
- 6.2. Emri dhe mbiemri i qytetarit, shkruhet në alfabetin latin në regjistrin përkatës të gjendjes civile.
- 6.3. Për rastet nga paragrafi 1 i këtij neni shkrimi i përdorur në gjuhën zyrtare, nuk duhet të modifikojë formën e emrit personal në gjuhën origjinale.

Neni 7 Caktimi i emrit personal të fëmijës

- 7.1. Emrin personal të fëmijës e caktojnë prindërit apo personat e autorizuar sipas Ligjit mbi familjen.
- 7.2. Emrin personal të fëmijës e caktojnë prindërit me marrëveshje.

7.3 Nëse njëri prej prindërve nuk është i njohur, nuk është në jetë apo nuk mund t'i kryej të drejtat prindërore, emrin personal të fëmijës e cakton prindi tjetër.

7.4 Caktimi i mbiemrit të fëmijës rregullohet sipas Ligjit mbi familjen.

7.5. Nëse prindërit e fëmijës nuk janë më në jetë, apo nuk mund t'i kryejnë obligimet prindërore, emrin personal të fëmijës e cakton personi, të cilit i është besuar kujdesi mbi fëmijën me pëlqim të qendrës kompetente për punë sociale.

7.6. Në rastin e fëmijës së gjetur, atij i caktohet emri dhe mbiemri nga organi kompetent i kujdestarisë.

Neni 8

Caktimi i emrit personal të fëmijës, nëse nuk ka marrëveshje të prindërve

8.1. Nëse prindërit nuk e caktojnë emrin personal të fëmijës në afatin e paraparë, në nenin 9 paragrafi 2 i këtij ligji, për shkak se nuk kanë arritur marrëveshje, atyre për arritjen e marrëveshjes për caktimin e emrit personal u ndihmon organi i kujdestarisë.

8.2. Nëse prindërit nuk merën vesh për emrin personal të fëmijës, atëherë emrin personal të fëmijës e cakton organi i kujdestarisë.

Neni 9

Regjistrimi i emrit personal

9.1. Emri personal regjistrohet në regjistrin përkatës të gjendjes civile, pranë organi kompetent në vendin e lindjes.

9.2. Regjistrimi pranë organit kompetent behët më së voni 30 ditë pas lindjes së fëmijës.

9.3. Prindërit ose personat e autorizuar me këtë ligj, janë të obliguar që brenda 15 ditësh nga lindja të paraqesin kërkesën për regjistrimin e emrit të fëmijës.

9.4. Emri personal në regjistrin përkatës të gjendjes civile dhe në dokumentet të tjera publike shënohet me shkronja dhe shenja, që janë të caktuara me ligj, i cili e rregullon regjistrimin në regjistrin përkatës të gjendjes civile.

Kreu II

KORRIGJIMI DHE NDËRRIMI I EMRIT PËRSONAL

Neni 10

Qytetari ka të drejtë në korrigjimin dhe ndërrimin e emrit personal.

Neni 11

Mënyra e korrigjimit të emrit personal

11.1. Nëse në regjistrat e gjendjes civile janë bërë gabime gjatë regjistrimit në emrin personal, qytetari ka të drejtë në korrigjimin e emrit personal në vendin e lindjes ku mbahet regjistri i gjendjes civile.

11.2. Qytetari i moshës së mitur mund ta korrigjojë emrin personal në baze të kërkesës së bërë nga përfaqësuesi ligjor apo përfaqësuesi i autorizuar.

11.3. Korrigjimi nuk mund të ndryshojë kuptimin dhe përmbajtjen e emrit personal.

Neni 12

Mënyra e ndërrimit të emrit personal

Qytetari i moshës madhore mund ta ndërrojë emrin personal në bazë të kërkesës së tij.

Neni 13

Ndërrimi i emrit personal gjatë adoptimit bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit mbi familjen.

Neni 14

Ndërrimi i mbiemrit gjatë lidhjes së martesës bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit mbi familjen.

Neni 15

Mbiemri gjatë lidhjes së martesës me të huajin

Nëse qytetari i Kosovës, i cili ka marr vendbanim të përhershëm në shtetin e huaj lidhë kurorë para organeve të shtetit të huaj me shtetasin e atij shteti, mbiemrin e zgjedhur pas lidhjes së kurorës, atë mbiemër në Kosovë e përdorë në formë dhe mënyrë, siç përdoret në shtetin e bashkëshortit, në harmoni me rregullat në fuqi të atij shteti dhe nenit 4.3 të këtij ligji.

Neni 16

Ndërrimi i mbiemrit pas zgjidhjes së martesës

16.1. Pas shkurorezimit, bashkëshortët e ndarë mund ta mbajnë mbiemrin që e kanë zgjedhur gjatë lidhjes së martesës.

16.2. Bashkëshorti-ja, i cili më rastin lidhjes së martesës e ka ndryshuar mbiemrin, pas zgjidhjes së martesës mund të marrë mbiemrin e mëparshëm.

Neni 17

Procedura për ndërrimin e emrit personal në bazë të kërkesës

17.1. Kërkesës për ndërrimin e emrit personal, paraqitësi i kërkesës duhet t'i bashkangjes vërtetimin se nuk është nen hetime.

17.2. Për kërkesën për ndërrimin e emrit personal vendos organi kompetent sipas vendbanimit, të i cili është bërë kërkesa.

17.3. Aktvendimi për ndërrimin e emrit personal i përcillet zyrës së gjendjes civile, ku është bërë regjistrimi i lindjes, respektivisht regjistrimi i lidhjes së martesës së palëve përkatëse.

Neni 18

Pengesat për ndërrimin e emrit personal

18.1. Qytetarit kundër të cilit zhvillohet procedura për veprë penale për të cilën ndiqet sipas detyrës zyrtare i cili është dënuar për veprë të këtillë penale, derisa nuk i është ekzekutuar dënimi ose gjithnjë derisa të vazhdojnë pasojat juridike të dënimit, si dhe as personit për të cilin konstatohet se kërkesën e ka paraqitur për t'iu shmangur detyrimeve të përcaktuara me ligj, nuk do t'i lejohet ndërrimi i emrit personal.

18.2. Nëse emri personal i është ndërruar qytetarit, kundër të cilit zhvillohet procedura penale për veprë penale, zyra e gjendjes civile që në afatin prej tre ditësh pas aprovimit të ndërrimit duhet ta njoftojë gjykatën në të cilën zhvillohet procedura penale.

18.3. Zyra e regjistrimit civil mund të kërkojë nga Gjykata dhe Prokuroria verifikimin e vërtetësisë të të dhënave të parashtruara nga aplikuesi lidhur me dokumentet nga neni 17 i këtij ligji.

18.4. Nëse emri personal është ndërruar me kërkesë të palës në procedurë administrative të organit të gjendjes civile, për pesë vitet e ardhshme, palës nuk do t'i lejohet sipas së njëjtës procedurë ndërrimi i serishëm i emrit personal nga organi i gjendjes civile.

Neni 19

Ndërrimi i emrit personal të miturit në bazë të kërkesës

19.1. Qytetarit të moshës se mitur mund t'i ndërrohet emri personal me kërkesën e përfaqësuesit ligjor. Nëse ndërrimin e emrit personal e kërkon kujdestari-ja për këtë duhet të jap pëlqimin edhe qendra kompetente për punë sociale ku edhe gjatë kësaj procedure duhet të respektohet më së shumti interesi i fëmijës.

19.2. Ndërrimi i emrit personal të personit të mitur të moshës mbi 10 vjet, mund të bëhet vetëm me pëlqimin e tij, përveç rasteve kur fëmija ka të meta psikike.

19.3. Nëse prindërit jetojnë të ndarë, ndërrimin e emrit personal të fëmijës mund ta kërkojë njëri nga prindërit, të i cili fëmija jeton, respektivisht atij të cilit i është besuar përkujdesja dhe edukimi, nëse për këtë pajtohet prindi tjetër.

19.4. Nëse prindi tjetër nuk pajtohet me ndërrimin e emrit personal të fëmijës, atyre për arritjen e marrëveshjes për ndërrimin e emrit u ndihmon qendra për punë sociale.

19.5. Pëlqimi i prindit tjetër nuk është i nevojshëm, nëse vendqëndrimi i tij nuk dihet, apo nëse i është marrë zotësia për veprim apo e drejta prindërore.

Neni 20

Vlefshmëria dhe regjistrimi i ndërrimit të emrit personal

20.1. Ndërrimi i emrit personal që është si pasojë e ndryshimeve të raporteve juridike familjare, vlen nga dita e dhënies së deklaratës, respektivisht nxjerrjes së vendimit meritator nga organi kompetent.

20.2. Ndërrimi i emrit personal duhet të regjistrohet në regjistrin përkatës të gjendjes civile brenda 5 ditëve, që nga momenti i njoftimit për aprovim të ndryshimit.

Neni 21

Mbikëqytja

Mbikëqytjen mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji e bën Ministria e Punëve të Brendshme.

Neni 22

Dispozitat ndëshkuese

Qytetari që përdorë emrin personal në kundërshtim me rregullat e nenit 3 paragrafit 2 të këtij ligji, dënohet me gjobë për kundërvajtje prej 200 Euro.

Neni 23

Secili nga prindërit, që nuk e lajmëron emrin personal të fëmijës në afatin e paraparë në paragrafin 2 të nenit 9 të këtij ligji, dënohet me gjobë prej 100 Euro.

Neni 24

Te gjitha mjetet materiale të cilat përfitohen nga gjobat, derdhen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

Kreu III

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE

Neni 25

Ky ligj, nuk vepron në emrat personalë, të cilat shtetasve ua kanë caktuar sipas ligjeve, të cilat kanë qenë në fuqi gjatë dhënies së emrave të tyre personal.

Neni 26

Ky ligj i shfuqizon të gjitha dispozitat e ligjit të aplikueshëm me të cilat është në papajtueshmëri.

Neni 27

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Ligji Nr. 02/ L-118
13 prill 2007

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

Kolë Berisha